Blv. Zhan d'Ark , nr. 3
Tiranë, 1001
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2222 411

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

# Tregtia e jashtme e mallrave

## Korrik 2017

**Tiranë, më 17 Gusht 2017:** Në Korrik 2017 eksportet e mallrave arritën vlerën 25 mld lekë, duke u rritur me 9,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 9,4 %, në krahasim me Qershor 2017. Importet e mallrave në Korrik 2017 arritën vlerën 55 mld lekë, duke u rritur me 9,2 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me 3,7 %, në krahasim me Qershor 2017. Deficiti tregtar i këtij muaji është 30 mld lekë, duke u rritur me 8,9 %, krahasuar me Korrik 2016 dhe duke u ulur me12,3 %, në krahasim me Qershor 2017.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në tregtinë e mallrave, Korrik 2015 – Korrik 2017 (%)




Në shtatë muajt e parë eksportet e mallrave arritën vlerën 158 mld lekë, duke u rritur me 12,9 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 350 mld lekë, duke u rritur me 6,3 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 192 mld lekë, duke u rritur me 1,4 %, krahasuar me 2016.

Për publikim17/08/2017

*Vijon*

**Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Rritja vjetore e eksporteve prej 9,7 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “tekstile dhe këpucë” me +5,6 pikë përqindje, “materiale ndërtimi dhe metale” me +3,6 pikë përqindje, “ushqime, pije, duhan” me +3,3 pikë përqindje. Grupi që ka ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, është: “minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -5,9 pikë përqindje.

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Korrik2017




Eksportet, gjatë këtij shtatë mujori janë rritur me 12,9 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “materiale ndërtimi dhe metale” me +5,0 pikë përqindje, “tekstile dhe këpucë” me +3,9 pikë përqindje, “ushqim, pije, duhan” me +1,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve, nuk ka ndikuar negativisht asnjë grup.

**Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Rritja vjetore e importeve prej 9,2 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “materiale ndërtimi dhe matale” me +3,8 me pikë përqindje, “minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,2 pikë përqindje, “tekstile dhe këpucë” me +1,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “ushqime, pije, duhan” me -0,2 pikë përqindje.

**Fig.3 Ndikimii grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Korrik2017**




Importet, gjatë këtij shtatë mujori, janë rritur me 6,3 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “produkte kimike dhe plastike” me +1,4 pikë përqindje, “tekstile dhe këpucë” me +1,2 pikë përqindje, “ushqim, pije, duhan” me +0,9 pikë përqindje.Në ndryshimin vjetor të eksporteve, nuk ka ndikuar negativisht asnjë grup.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**

Në muajin Korrik 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Korrik 2016 janë: Italia me (16,5 %), Kosova me (36,9 %) dhe Spanja me (216,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina me (-46,6 %), Mali i Zi me (-1,0 %) dhe Rumania me (-6,4 %).

Gjatë këtij shtatëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (7,8 %), Kosova me (28,4 %) dhe Spanja me (175,8 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Bullgaria me (-7,4 %), Zvicra me (-44,3 %) dhe Kroacia me (-33,8 %).

Në muajin Korrik 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Korrik 2016 janë: Italia me (10,5 %), Greqia me (19,8 %) dhe Turqia me (39,9 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Franca me (-57,5 %), Rusia me (-22,2 %) dhe Shtetet e Bashkuara me (-41,7 %).

Gjatë këtij shtatëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (4,9 %), Greqia me (12,3 %) dhe Turqia me (16,5 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania me (-5,7 %), Kina me (-9,1 %) dhe Franca me (-8,8 %).

**Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Korrik 2017**




Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 70,3 % të të gjithë tregtisë. Në Korrik 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 80,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 65,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (39,1 %), Greqia (7,9 %), Gjermania (6,2 %) dhe Kina (6,0 %).

Shkëmbimet tregtare, për shtatëmujorin 2017, me vendet e BE zënë 66,9 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Korrik 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 77,4% të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 62,2 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (37,6 %), Gjermania (7,1 %), Greqia (7,1 %) dhe Kina (6,2 %).

## Tab. 1 Qarkullimi i mallrave (miliardë lekë)

| Vitet | Muajt | Eksporte | NdryshimiVjetor | Importe | NdryshimiVjetor | BilanciTregtar | % e mbulimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2000 | | 37 | -23,5 | 157 | -1,5 | -120 | 23,6 |
| 2001 | | 44 | 19,1 | 190 | 21,0 | -146 | 23,2 |
| 2002 | | 47 | 7,7 | 210 | 10,6 | -163 | 22,6 |
| 2003 | | 54 | 14,7 | 226 | 7,4 | -171 | 24,1 |
| 2004 | | 62 | 14,0 | 236 | 4,5 | -174 | 26,3 |
| 2005 | | 66 | 6,0 | 262 | 11,1 | -196 | 25,1 |
| 2006 | | 77 | 17,6 | 299 | 14,1 | -222 | 25,9 |
| 2007 | | 97 | 25,5 | 376 | 25,8 | -279 | 25,8 |
| 2008 | | 113 | 15,8 | 440 | 16,9 | -327 | 25,6 |
| 2009 | | 105 | -7,2 | 429 | -2,5 | -324 | 24,4 |
| 2010 | | 162 | 54,6 | 478 | 11,4 | -316 | 33,8 |
| 2011 | | 197 | 21,9 | 544 | 13,9 | -347 | 36,2 |
| 2012 | | 213 | 8,2 | 528 | -2,9 | -315 | 40,3 |
| 2013 | | 246 | 15,7 | 517 | -2,1 | -271 | 47,6 |
| 2014 | | 256 | 3,8 | 552 | 6,7 | -297 | 46,3 |
| 2015 | | 243 | -4,9 | 545 | -1,4 | -301 | 44,7 |
| 2016 | | 243 | 0,1 | 579 | 6,4 | -336 | 42,0 |
| | | | | | | | |
| 2014 | 01 - 14 | 18 | -1,4 | 35 | 2,2 | -17 | 51,2 |
| | 02 - 14 | 20 | 27,9 | 39 | 17,5 | -19 | 51,8 |
| | 03 - 14 | 21 | 10,4 | 42 | 11,1 | -21 | 50,1 |
| | 04 - 14 | 23 | 10,3 | 44 | 6,8 | -22 | 51,3 |
| | 05 - 14 | 25 | 9,1 | 48 | 6,9 | -23 | 52,5 |
| | 06 - 14 | 22 | 8,3 | 49 | 18,9 | -27 | 45,6 |
| | 07 - 14 | 23 | -5,7 | 47 | -2,5 | -24 | 48,6 |
| | Janar – Korrik 2014 | 153 | 7,6 | 306 | 8,3 | -153 | 50,0 |
| | | | | | | | |
| 2015 | 01 - 15 | 18 | -0,6 | 35 | 0,9 | -17 | 50,4 |
| | 02 - 15 | 18 | -9,4 | 39 | -0,8 | -20 | 47,3 |
| | 03 - 15 | 22 | 4,1 | 44 | 4,6 | -22 | 49,9 |
| | 04 - 15 | 21 | -8,5 | 44 | -1,4 | -23 | 47,6 |
| | 05 - 15 | 24 | -4,8 | 44 | -8,0 | -20 | 54,3 |
| | 06 - 15 | 24 | 7,4 | 49 | -0,8 | -25 | 49,3 |
| | 07 - 15 | 23 | -1,6 | 52 | 11,1 | -30 | 43,0 |
| | Janar – Korrik 2015 | 150 | -2,0 | 308 | 0,8 | -158 | 48,7 |
| | | | | | | | |
| 2016 | 01 - 16 | 16 | -7,8 | 35 | -1,0 | -18 | 47,0 |
| | 02 - 16 | 18 | -4,4 | 42 | 7,6 | -24 | 42,0 |
| | 03 - 16 | 19 | -12,7 | 47 | 5,6 | -28 | 41,2 |
| | 04 - 16 | 21 | 1,7 | 52 | 19,0 | -31 | 40,7 |
| | 05 - 16 | 21 | -14,8 | 52 | 16,7 | -31 | 39,6 |
| | 06 - 16 | 23 | -6,4 | 52 | 6,2 | -29 | 43,5 |
| | 07 - 16 | 23 | -0,2 | 50 | -4,5 | -28 | 44,9 |
| | Janar – Korrik 2016 | 140 | -6,5 | 330 | 7,0 | -189 | 42,5 |
| | | | | | | | |
| 2017 | 01 - 17 | 19 | 15,5 | 35 | 0,9 | -16 | 53,8 |
| | 02 - 17 | 20 | 14,2 | 44 | 5,1 | -24 | 45,7 |
| | 03 - 17 | 24 | 22,0 | 54 | 14,9 | -30 | 43,8 |
| | 04 - 17 | 24 | 13,7 | 50 | -3,9 | -26 | 48,1 |
| | 05 - 17 | 24 | 18,2 | 56 | 7,4 | -31 | 43,6 |
| | 06 - 17 | 23 | -0,2 | 57 | 9,2 | -34 | 39,7 |
| | 07 - 17 | 25 | 9,7 | 55 | 9,2 | -30 | 45,1 |
| | Janar – Korrik 2017 | 158 | 12,9 | 350 | 6,3 | -192 | 45,2 |

## Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

| | Eksporte | | | | Importe | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kor.-16 | Kor.-17 | Jan.- Kor. 2016 | Jan.- Kor. 2017 | Kor.-16 | Kor.-17 | Jan.- Kor. 2016 | Jan.- Kor. 2017 |
| **Vendet e BE-së** | **18.166** | **19.819** | **110.148** | **122.363** | **33.017** | **35.986** | **207.145** | **217.944** |
| Austri | 72 | 153 | 655 | 933 | 516 | 754 | 3.337 | 3.569 |
| Mbretëri e Bashkuar | 61 | 26 | 287 | 237 | 371 | 392 | 2.427 | 3.064 |
| Gjermani | 756 | 1.009 | 4.631 | 6.455 | 3.641 | 3.909 | 31.258 | 29.473 |
| Greqi | 958 | 1.079 | 6.565 | 6.998 | 4.319 | 5.175 | 25.996 | 29.198 |
| Itali | 11.834 | 13.784 | 80.165 | 86.417 | 15.610 | 17.242 | 99.749 | 104.619 |
| Spanjë | 486 | 1.538 | 2.919 | 8.053 | 1.093 | 1.571 | 7.197 | 7.905 |
| Kroaci | 62 | 48 | 694 | 460 | 526 | 509 | 2.463 | 2.642 |
| Të tjera të BE-së | 3.937 | 2.180 | 14.232 | 12.810 | 6.940 | 6.436 | 34.718 | 37.473 |
| Kinë | 737 | 393 | 3.139 | 4.887 | 4.036 | 4.395 | 29.327 | 26.651 |
| Kosovë | 1.382 | 1.893 | 9.241 | 11.867 | 492 | 692 | 3.123 | 4.528 |
| Maqedonia | 534 | 757 | 3.320 | 4.657 | 689 | 730 | 4.081 | 4.740 |
| Rusi | | 11 | 46 | 55 | 801 | 623 | 6.556 | 5.138 |
| SHBA | 177 | 213 | 880 | 1.519 | 993 | 579 | 6.255 | 5.325 |
| Turqi | 176 | 272 | 905 | 1.273 | 3.228 | 4.514 | 24.858 | 28.965 |
| Ukrainë | 24 | 26 | 117 | 296 | 195 | 166 | 2.063 | 2.109 |
| Zvicër | 124 | 105 | 1.443 | 804 | 464 | 535 | 4.160 | 4.674 |
| Tëtjera | 1.185 | 1.194 | 10.864 | 10.450 | 6.152 | 6.467 | 41.941 | 50.098 |
| **Gjithsej** | **22.505** | **24.682** | **140.102** | **158.171** | **50.067** | **54.687** | **329.509** | **350.172** |

## Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

| Grup-mallrat | Eksporte | | | | Importe | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kor.-16 | Kor.-17 | Jan.- Kor. 2016 | Jan.- Kor. 2017 | Kor.-16 | Kor.-17 | Jan.- Kor. 2016 | Jan.- Kor. 2017 |
| **Gjithsej** | **22.505** | **24.682** | **140.102** | **158.171** | **50.067** | **54.687** | **329.509** | **350.172** |
| Ushqime, pije, duhan | 1.786 | 2.527 | 13.810 | 16.163 | 9.538 | 9.435 | 57.226 | 60.287 |
| Minerale, lëndë djegëse, en.el. | 4.414 | 3.092 | 25.017 | 25.979 | 3.950 | 4.573 | 27.002 | 29.796 |
| Produkte kimike dhe plastike | 372 | 397 | 2.469 | 2.670 | 7.244 | 7.583 | 46.381 | 50.994 |
| Lëkurë dhe artikujt prej tyre | 246 | 320 | 1.723 | 1.832 | 1.653 | 1.882 | 10.619 | 11.503 |
| Prodhime druri dhe letre | 593 | 748 | 4.415 | 4.456 | 2.139 | 2.332 | 13.040 | 13.337 |
| Tekstile dhe këpucë | 10.606 | 11.875 | 64.270 | 69.761 | 6.893 | 7.499 | 46.296 | 50.270 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 2.830 | 3.632 | 17.694 | 24.699 | 5.049 | 6.953 | 44.515 | 45.614 |
| Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi | 955 | 1.328 | 6.561 | 8.303 | 11.747 | 12.195 | 72.387 | 74.322 |
| Të tjera | 702 | 761 | 4.143 | 4.308 | 1.856 | 2.236 | 12.043 | 14.048 |

**Tab. 4 Eksportet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë,(Jan.- Kor. 2016, Jan.-Kor. 2017)**

**( milionë lekë)**

| | Itali | | Kosovë | | Spanjë | | Greqi | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2016 | 2017 | 2016 | 2017 | 2016 | 2017 | 2016 | 2017 |
| **Gjithsej** | **80.165** | **86.417** | **9.241** | **11.867** | **2.919** | **8.053** | **6.565** | **6.998** |
| Ushqim, pije duhan | 3.939 | 3.898 | 1.653 | 1.796 | 464 | 481 | 1.297 | 1.063 |
| Minerale, lëndë djegëse, ener. elek. | 5.338 | 5.109 | 1.874 | 3.282 | 620 | 6.112 | 276 | 191 |
| Produkte kimike dhe plastike | 799 | 782 | 747 | 715 | 0 | 13 | 226 | 333 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 1.563 | 1.418 | 0 | 2 | 3 | 29 | 29 | 38 |
| Prodhime druri dhe letre | 3.293 | 3.168 | 172 | 211 | 3 | 3 | 538 | 623 |
| Tekstile dhe këpucë | 51.496 | 55.084 | 45 | 83 | 1.483 | 1.201 | 2.849 | 3.156 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 7.522 | 9.857 | 3.630 | 4.685 | 313 | 207 | 1.082 | 979 |
| Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi | 4.443 | 5.081 | 374 | 403 | 22 | 1 | 36 | 366 |
| Të tjera | 1.774 | 2.021 | 744 | 689 | 11 | 5 | 230 | 248 |

**Tab. 5 Importet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, (Jan.- Kor. 2016, Jan.-Kor. 2017)**

**(milionë lekë)**

| | Itali | | Gjermani | | Greqi | | Turqi | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2016 | 2017 | 2016 | 2017 | 2016 | 2017 | 2016 | 2017 |
| **Gjithsej** | **99.749** | **104.619** | **31.258** | **29.473** | **25.996** | **29.198** | **24.858** | **28.965** |
| Ushqim, pije duhan | 10.019 | 10.681 | 2.526 | 2.366 | 8.466 | 7.968 | 3.143 | 3.451 |
| Minerale, lëndë djegëse, ener. elek. | 11.380 | 8.774 | 307 | 335 | 2.816 | 4.425 | 571 | 1.165 |
| Produkte kimike dhe plastike | 9.795 | 11.075 | 3.748 | 4.453 | 4.591 | 4.740 | 3.642 | 4.317 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 8.339 | 9.004 | 2 | 6 | 90 | 45 | 234 | 203 |
| Prodhime druri dhe letre | 3.694 | 3.709 | 492 | 456 | 1.532 | 1.847 | 1.641 | 1.980 |
| Tekstile dhe këpucë | 24.192 | 26.067 | 1.551 | 1.474 | 2.175 | 2.320 | 8.054 | 8.769 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 9.968 | 11.987 | 8.925 | 4.674 | 3.826 | 5.322 | 2.895 | 3.451 |
| Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi | 18.917 | 19.564 | 12.759 | 14.631 | 1.616 | 1.476 | 3.551 | 4.281 |
| Të tjera | 3.445 | 3.756 | 948 | 1.078 | 885 | 1.055 | 1.126 | 1.350 |

# Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri ne kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifat doganore.

http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

**Shpjegimi i simboleve**

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

÷ deri